

## Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

### Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 09-15.12.2024

Janë testuar gjithsej 87 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=194) është shënuar një rënie prej 30,4%.

Nuk janë regjistruar raste pozitive.

*Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 09-15.12.2024*

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
09.12.2024	11	0	0,0%
10.12.2024	10	0	0,0%
11.12.2024	27	0	0,0%
12.12.2024	14	0	0,0%
13.12.2024	11	0	0,0%
14.12.2024	6	0	0,0%
15.12.2024	8	0	0,0%
<b>Gjithsej</b>	<b>87</b>	<b>0</b>	

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 2 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (18-24.11.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

Për momentin nuk ka raste aktive me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Gjatë vitit 2024, deri më 15.12.2024, janë regjistruar gjithsej 1.746 raste me COVID-19. Në muajin nëntor të vitit 2024 (12) regjistrohet një rënie prej 78,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 15.12.2024, janë testuar gjithsej 13.054 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

### **VLERËSIMI I RREZIKUT**

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut. Në dy muajt e fundit regjistrohet një rënie e numrit të rasteve pozitive, por edhe i numrit të testimeve.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

### **Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll**

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).<sup>1</sup>

**Shkup, 16.12.2024**

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse**

**Instituti i Shëndetit Publik**

---

<sup>1</sup> <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>